



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILICIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATES PERGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izleazna

Nr. 1-161
Br.

Data 16.09.2019
Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI²⁵, mbledhja e 10) me dt.24.09.2019 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

- 1.Arsyetimi për mungesë
- 2.Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draf Buxhetit për vitin 2020 dhe parashikimi për vitet 2021-2022
- 4.Shqyrtimi i drafte Rregullores për subevencionimin e energjisë elektrikenë zonën rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesave
- 6.Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliç - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.08.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Vlora Mjekiqi Kabashi, drejtoreshë e DSHMS-së, Fatmir Bërbatovci, drejtor për infrastrukturë dhe zhvillim lokal, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Bejtullah Mjekiqi, drejtor i Drejtorisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural, përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

- 1. Arsytimi për mungesë**
- 2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores Për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore**
- 4. Shqyrtimi i Draft-Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për dhënin në diskutim publik të Draft Rregullorës për Administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit**
- 6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë**
- 7. Shqyrtimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënie e pronës komunal në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë :**
 - a) Investitori : Kolegji BIZNESI, Prishtinë**
 - b) Investitori : APOLLONIA ,SH.P.K**
- 8. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike Investimet kapitale**
- 9. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së (rishikimi i vendimit nr I-106, të dt.28.06.2019)**

10. Shqyrtimi i kërkesave

11. Të ndryshme

Kryesuesi – Fillimisht kërkon nga anëtari i ri z. Muhamet Mustafa, i cili vjen sipas radhës nga (AAK), në vend të anëtarit të mëhershëm z. Agon Mjekiqi, që të japë betimin për anëtar të Kuvendit komunal.

Muhamet Mustafa dha betimin solemn për anëtar të Kuvendit komunal.

Kryesuesi - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u pranua njëzërit nga të gjithë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Fatmir Bektoshi dhe Slavisa Spasic me leje.

Pika 2 e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi për paraqitjen e ndryshim plotësimit të Rregullores për ndarjen e bursave, fjalën ia dha drejtorit të DKA-së.

Agim Spahi – Ne fatbardhësisht në sistemin e Arsimit kemi tregues të besueshëm se jemi ndoshta një hap para sa i përket performancës së cilësisë në Republikën e Kosovës dhe ky fakt na gëzon. Arsyeja tjetër që është më e fortë specifikisht unë e përgëzoj një asambleiste, që është e nderuar prezente për fëmijun e vet, që ka zënë vendin e parë në nivel të Republikës së Kosovës, në klasën e VIII në lëminë e fizikës i cili quhet Yll Dragusha. Fatbardhësisht janë edhe 6 garues tjerë që e kanë vendin e parë, ndërsa të tjerët kanë vend të dytë dhe të tretë. Ne kemi mendue që ia vlen me ndryshue dhe plotësue Rregulloren me shpërblime për nxënës të këtyre niveleve, për performancën e treguar në garat komunale dhe republikane.

Ndryshim plotësimet e Rregullores janë:

Në nenin 5, është propozue ndryshimi që Komisionin për ndarjen e bursave, të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore ta formon Kryetari, ndërsa Komisionin për ankesa ta formon Kuvendi komunal.

Në nenin 9, kemi një plotësim ndryshim që ju nuk e keni në tekstin e Rregullores, por nga debati ka lindur që përveç studentëve, fëmijëve të dëshmorëve të vitit të parë të studimeve të ju ndahet bursë edhe fëmijëve, që janë me asistencë sociale nga familjet e aspektit ekonomik financiar.

Te neni 15, është specifikue Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve në dispozicion ndanë shpërblime për nxënës nga Komuna e Obiliqit, të cilët do të jenë fitues në garat në nivel Komune dhe Republike, për 3 nivelet, vendet e para. Vazhdon pasuesi tjetër Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve në dispozicion ndanë shpërblime për mësimdhënës nëse, nxënësit e tyre kanë fitue për 3 vendet e para në garat republikane në lëminë përkatëse.

Neni 16, Kryetari i Komunës merrë vendim për ndarje të shpërblimeve dhe lartësinë e shpërblimit për secilin vend të radhitur në 3 vendet e para, sipas nenit paraprak për nivelin komunal dhe republikan për nxënës ndaras dhe ndaras për mësimdhënës.

Neni 17, shpërblimet ndahen pa përfunduar viti kalendarik, përkatësisht përkatës në të cilin janë mbajtur garat dhe janë zënë 3 vendet e para.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, e kam bërë një analizë të thukët, te neni 9 më erdhi shumë mirë që kanë hy edhe vitet e para, kategoritë e dëshmorëve, familjet me asistencë sociale. Unë dua që për shkak të kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë te ky nen, të shtohet ndryshimi në mes tyre në përqindje, që me ditë përparësisht se çfarë përqindje kanë sepse nëse shkojmë nga e para në të pestën me 20 % bjen ndryshim shumë i madh. Është shumë mirë që është bërë ndryshimi i Rregullores, që po duket në fakt se për çdo vit Komuna po e rritë përqindjen e dhënies së bursave.

Armend Rushiti – Në parim edhe unë e përkrahu dhe i përgëzoj të gjithë ata që kanë marrë pjesë në ndryshimin e Rregullores, por te neni 8, te kushtet dhe kriteret për të fituar burse për studentë në pikën 1.3, te niveli i doktoraturës mendoj se është e nevojshme që të futet edhe niveli i doktoraturës në lëminë e

mjekësisë. Arsyeja e kësaj është se unë nuk e di në Komunën e Obiliqit, që kemi ndonjë doktor shkence dhe besoj se kjo është e arsyeshme.

Kryesuesi – Përgjegjet se niveli i doktoraturës i ka përfshirë të gjithë cilëndo qoftë lëmi të doktoraturës, që mund të jetë i ekonomisë, politikës, shëndetësisë etj. do të thotë nuk është specifikuar lëmia.

Armend Rushiti – Këtu, nuk ka dhe është nga lëmitë e shkencave natyrore, teknike dhe ambientit. Unë nuk e di se në Komunën e Obiliqit, është dikush me doktoraturë në kuadër të mjekësisë.

Kryesuesi – Sqaron se kanë menduar se vetëm këto shkencë kanë doktor dhe s'kanë menduar për të tjerët. Kjo është çështje teknike që mund ta rregullojmë.

Nazmi Gashi – Propozon me ia nda një shpërbllim drejtorit sepse e ka merituar.

Kryesuesi – Besoj se Kryetari e bën vlerësimin në fund të vitit dhe ne jemi mirënjohës për kontributin e drejtorit që e ka dhënë në Arsim dhe vazhdon me dhënë.

Armend Rushiti – Dihet se doktoratura kushton dhe në kuadër të kësaj a parasihet ndonjë shumë se sa mund të jetë kjo bursë, nëse kryhet dikund jashtë se në Kosovë dihet mundësia e doktoraturës.

Agim Spahiu – Në këto 2 dispozita, që u involvuan asambleistët nuk ka pasë ndërhyrje, nuk ka pasë as ndryshim, as plotësim dhe këto 2 dispozita janë origjinale nga Rregullorja aktuale që është në fuqi. Në përqindje nuk shkohet, por shkohet në vlerë absolute sepse është një nen që në bazë të mjeteve në disponim Kryetari në Këshillin e drejtorëve, e cakton lartësinë e shumës së bursës. Prandaj, kur thuhet lartësinë e bursës, kuptohet edhe për bursën në nivelin e doktoraturës.

Kryesuesi – Te neni 9, shtohet poashtu edhe për rastet sociale dhe te neni 8, pika 1.3, niveli i doktoraturës, duhet të jetë në të gjitha lëmitë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota “Për” 2 vota “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” e miratuan Rregulloren për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi për një sqarim më detal rreth Draft Planit Strategjik Parësor Shëndetësor në Komunën e Obiliqit, fjalën ia jepë Nënkryetarit të Komunës.

Ibush Mjekiqi – Në kohën kur ka fillue të bëhet kjo strategji, unë kam qenë drejtor i shëndetësisë dhe Kryetar i Komisionit, i cili Komision në vitin 2018 është formuar nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me sponzorizuesin tonë më të madh që ka qenë AQH-në dhe kemi bërë këtë strategji. Ky dokument është një prej dokumenteve më të rëndësishme që e ka përpiluar Drejtorja e shëndetësisë, të hartuar në 8 kapituj. Komuna e Obiliqit, është hera e parë që përpilon një dokument të tillë shumë të rëndësishëm në nivel Komune, aq më parë kur dihet shkalla e ndotjes të ambientit të Komunës tonë. Ky dokument ka për qëllim planifikimin strategjik të detalizuar të organizimit dhe funksionimit të shëndetësisë në Komunën e Obiliqit për periudhën 2020-2024 dhe propozoj që ju ta votoni.

Shaip Paloja – Draft plani strategjik është një dokument mjaft voluminoz dhe në të përfshihen mjaft të dhëna të rëndësishme për Komunën tonë, bile ka shumë të dhëna që janë shqetësuese duke pasë parasysh se ne jetojmë në një zone industriale, ku ndotjet janë enorme. Në mes të dhënave të shumta, ajo që mua më ka brengosë më së shumti janë sëmundjet e sistemit respirator të fëmijët në Komunën tonë, që është 50 %. Një shqetësim tjetër është se banorët e Komunës së Obiliqit, janë me sëmundje malinje, me kancer për dallim nga Komunitat tjera, që besoj edhe në rajon janë të qfaqura 30 %, më tepër në Komunën tonë. Mendoj se duhet të bëhet një plan i hollësishëm, të bëhet preventiva dhe të tregohen masat të cilat duhet të merren në të ardhmen. Patjetër duhet të funksionalizohet edhe mjekësia sekondare dhe ndoshta ligji nuk na lejon, por duhet të bëjmë gjithçka pasi që e kemi Ligjin për Obiliqin dhe jemi një zonë industriale, një zonë e veçantë në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi – Ky është nivel i përgjithshëm i strategjisë se nga është orientimi dhe si është gjendja faktike, ndërsa nivelin e detyrave të punës dhe prioritetet do të caktohen me vendime të veçanta dhe planet e punës vjetore.

Armend Rushiti – Unë e përgëzoj gjithë grupin punues që kanë marrë pjesë në këtë dokument, por është dashur që të përfshihen të gjithë profesionistët mjekësor, në mënyrë që secili ta japë kontributin në lëminë e vet. Ky është një dokument mjaft voluminoz dhe shpresoj që të realizohet. Në kuadër të këtij dokumenti unë i kam disa vërejte

- Ndërtimi gjegjësisht zgjerimi i QKMF-së, kati i II-të, faktikisht po i bjen 2 vjet në bazë të këtij dokumenti që do të zgjerohet, do të thotë nuk është dashtë me lënë më gjatë sepse nevojat dihen se çfarë objekti është që nuk i plotëson aq kushtet, se është objekt i vogël për gjithë këta banorë. Mundësitë tash janë dhe është dashur më heret me u krye kjo punë, e jo me lënë në vitin 2021, faktikisht në fund të këtij mandati.

-Trajnimi i mjekëve familjarë për përdorimin e ultrazërit fillon në 3 mujorin e dytë të vitit 2020, ndërsa faktikisht aparati i ultrazërit, tek pas një viti në bazë të këtij dokumenti vjen. Kjo nuk përputhet sepse krejtë atë që e përvetëson në kuadër të atij trajnimit nëse nuk e përdorë pas një viti ajo dituri mund të harrohet, pasi që nuk zbatohet në kohën e duhur. Unë them se në momentin që bëhet trajnimi duhet të blehet edhe ultrazëri, në mënyrë që me përdorë menjëherë dhe me zbatue.

- Në kuadër të specializimit që parashihet në kuadër të Ligjit të Obiliqit, duhet të shihen se cilat janë më të nevojshme dhe këtu, po shihen se janë 4 specializime të reja që munden me fillue, nëse veç rregullohet kjo farë pune.

Kryesuesi – Kjo është më shumë çështje teknike se sa që është rreth strategjisë.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se sa i përket grupeve të angazhuara për hartimin e këtij dokumenti nuk ka qenë vetëm Komisioni, por kanë qenë grupet e ndryshme të interesit që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti. Poashtu, është mbajtur edhe debate publik përfundimtar, në të cilin të gjithë kanë pasë mundësi me i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta. Te impementimi i projektit për katin e II-të, ajo është paraparë duke u bazuar në hartimin e planit në mjetet buxhetore dhe në atë vit edhe ajo do të ndodhë. Sa i përket ultrazërit ne veç kemi ultrazë në QKMF dhe në këtë vit poashtu, furnizohet me një ultrazë tjetër, prandaj çdo gjë është në rregullë. Sa i përket edukimit doktori e din shumë mirë se është qendra e edukimit të vazhdueshëm, e cila i bën planet e edukimit, e jo Drejtoria komunale për shëndetësi.

Armend Rushiti – Unë e di që është ultrazëri, por ultrazëri për çka përdoret sepse ultrazëri që është, është për pjesët tjera specifike. Unë nuk e di që ka dhe nëse, ka atëherë pse planifikohet të blehet ultrazëri në vitin 2021.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet sepse i duhet popullatës së Komunës së Obiliqit dhe profesionistëve që punojnë aty.

Armend Rushiti – Më fal, por ultrazëri që është ju e dini se për çka përdoret.

Kryesuesi – Nëse, është mundësia me i bë 2 ultrazëra, pse jo dhe një mamograf që është kërkesë e nevojshme të cilën grupi i grave në nivel të Kosovës, e ka përkrahë.

Ibush Mjekiqi – Është me rëndësi që është një dokument i parë që është 5 vjeçar dhe është dokument që mund të rishikohet brenda 2 viteve. Konsideroj se është një dokument më i mirë i mundshëm që asnjëherë nuk e ka pasë Komuna e Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota “Për” e miratuan Planin Strategjik Parësor Shëndetësor në Komunën e Obiliqit.

Kryetari – Po e shohë se Kuvendi paska pësuar një ndryshim dhe i uroj z.Muhamet Mistafa, shëndet dhe suksese, ndërsa z.Fatos Kurshumlija i uroj mirëseardhje në Kuvend.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se në mbledhjen e dt.28.06.2019, ne kemi marrë një vendim për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri”. Gjatë debatit që e ka pasë DKRS-ja, e kanë parë se ka nevojë të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Draft Rregullores për administrimin fushave sportive dhe Shtëpive të Kulturës. Tash, propozoj që vendimi nr.1-111, i dt.28.06.2019, të shfuqizohet për arsye se kjo Rregullore bjen, dhe të merret vendim që Draft Rregullorja për administrimin e fushave sportive dhe Shtëpive të Kulturës, të delë në debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota “Për” e miratuan Shfuqizimin e vendimit nr.I-111, i dt.28.06.2019, për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”.

Kryesuesi – Propozon që të delë në debat publik Draft Rregullorja për administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota “Për” e miratuan Vendimin për dalje në debat publik të Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit. Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Caravodicë.

Aziz Bici – Unë po e lexoj pikën 6, pastaj kërkoj sqarim lidhur me Propozim Vendimin nr.11-795, i dt.25.07.2019, për shpalljen me interes të përgjithshëm public të parcelave kadastrane në ZK në Vodice. Pika 1, pasuesi i dytë thotë njësia kastrale nr.00526-0, toka ndërtimore oborr në sipërfaqe prej 335 m² tokë ndërtimore, shtëpi, ndërtesë në sipërfaqe prej 86 m². Sipërfaqja e gjithëmbarshme është 421 m², zyra kadastrale Caravodicë, Komuna e Obiliqit, e evidentuar në bazë të certifikatës së pronës KEK. Pasuesi i parë më bën me kuptue se është pronë private, ndërsa pasuesi tjetër delë se me certificate është pronë e KEK-ut. Tani, kërkoj sqarim se a është fjala për pronën private apo diçka tjetër.

Kryesuesi – Sqaron se të gjitha janë prona të KEK-ut sepse kështu është e regjistruar në kadastër.

Arben Berisha – Shpjegon se ne flasim me çështjen njësi kadastrale, do të thotë në gjeoportale dhe njësinë kadastrale e kemi kështu të evidentuar qysh është e përshkruar. Është e përshkruar tokë ndërtimore, oborr dhe kështu ka mbetë në Agjensionin kadastral, kështu që është gjithçka në rregullë.

Aziz Bici – Pyetja konkrete është se këto prona, a janë private dhe a janë duke i shfrytëzuar qytetarët, apo është pronë e KEK-ut.

Arben Berisha – Përgjegjet se është pronë e KEK-ut, e jo e qytetarëve.

Xhezide Dragusha – Pyeti ku ndodhet kjo, te cila pjesë është dhe për çka duhet të shfrytëzohet nëse jepet kjo tokë.

Arben Berisha – Përgjegjet se çështja është te hyrja e fshatit Palaj, e kalojmë urën dhe aty shtrihen pjesët. Ne jemi munduar me nxjerrë një pjesë bukur të mirë dhe sipërfaqja e tërësishme është 9 ha e 8 m². Ne e kemi bërë njëfarë harte, që të gjitha parcelat lidhen njëra me tjetrën, janë skaj rrugës dhe janë afër stadionit të fshatit. Të gjitha parcelat janë të KEK-ut, ndërsa me prona private nuk kemi përfshirë asgjë për arsye se nëse, i prekum pronat private duhet të bëhet shpronësimi.

Shaip Paloja – Unë pasi vijë nga ai fshat për sqarim mendoj se jam në ngjarje dhe di. Është e vërtetë se ato janë prona të KEK-ut, por më heret në vitet e 70-ta, aty ka qenë e ndërtuar një shtëpi private dhe ka jetue një banor i komunitetit sërbë. Nëse, ju kujtohet paslufte atë vend njëherë e ka marrë uji dhe TMK-ja ka intervenue, e atë familje e ka dislokue nga ai vend dhe aty është ai, e ka ndërtue shtëpinë, prona edhe atëherë dhe sot është pronë e KEK-ut. Poashtu, ma merrë mendja se është ajo ndërtesa e madhe që KEKu, ka filluar me ndërtue afër fabrikës së pajisjeve xehtare për ndërtimin e pjesëve për makina të rënda, kryesisht janë ato pjesë.

Hysni Mjeku – Pyetjen që deshta ta parashtroj e parashtroi znj.Xhezide dhe unë deshta vetëm me përshëndet z.Muhametin me i dëshirue shëndet dhe jetë institucionale të suksesshme. Ne edhe në KPF e kemi diskutue këtë çështje, por nuk e kemi ditur se cila pjesë e hyrjes është. Faktikisht këtu, nuk ka diçka kontestuese, do të thotë nuk ka diçka që ia vlen me kundërshtue.

Kryetari – Qëllimi i këtyre parcelave është që të krijohet një infrastrukturë edhe për fshatarët në atë zonë. Ne konsiderojmë se KEK-u, në 100 vitet e ardhshme në atë zonë nuk do të ketë operime dhe ka kuptim me gjelbërue një pjesë, me krijue një park për banorët dhe fusha sportive.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota “Për” e miratuan Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë, a) investitori Kolegji Biznesi Prishtinë dhe b) Investitori Apollonia Sh.P.K..

Kryetari – Edhe pse e kam potencuar sipas ligjit se i takon Kryetarit në rast kur vlera është mbi 10 %, e investimeve kapitale të vitit paraprak, ne e kemi shfrytëzue mundësinë që e kemi ftue edhe Ekzekutivin të jenë pjesë në pjesën e negocijimit. E dijmë të gjithë se kjo pjesë deri dikur ka qenë e bllokuar për shkak të Ibër Lepencit, por meqë është bërë si zgjidhje e Ibër Lepencit, ne të gjitha ato parcela i kemi bërë publike në faqen zyrtare me qëllim që të krijojmë mundësi të zhvillimit ekonomik për biznese. Kërkesat që kanë ardhë janë nga Apollonia për zgjerim, që pastaj e kemi trajtue edhe nga Kolegji Biznesi. Unë i kam ftuar edhe shëfat e grupeve parlamentare, që të jenë në dijeni dhe të bashkëbisedojmë. Poashtu, përfaqësuesit e këtyre kompanive ishin në prezentimin e projekt ideve të tyre dhe tani jemi te procedura e radhës që duhet të votoj Kuvendi.

Aziz Bici – Bazuar në takimin e dt.9.8.2019, me ftesë të Kryetarit, së bashku me kryesuesin e Kuvendit, me Kryetar të grupeve, me anëtarë të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës, Kopja e Planit nr.0011-6, në sipërfaqe prej 39435 m² dhe Kopjen e Planit nr.00111-4, në sipërfaqe prej 50307 m² me gjithsejt sipërfaqe 89742 m² së bashku me biznesin Apollonia SH.P.K. për njoftimin nga afër me aktivitetet që kryen kjo kompani gjatë prezentimit të bërë nga z.Maloku, në kujtesën time kanë mbetë disa të dhëna që tani në materialin që na është dorëzue nuk janë cekur. Mendoj se ka qenë e rëndësishme të cekem dhe këto janë kapaciteti i prodhimit të kësaj fabrike, që mendoj se është cekë rreth 200,000 ton, që nuk e di se a ka qenë mujor, vjetor apo nga viti 2014, kur e ka filluar prodhimin, por e ka përmendë 200,000. Z.Maloku, e ka përmendur se përfitimi i Komunës deri më tani ka qenë rreth 60,000 €, dhe në materialin që na është dorëzue nuk ceket as kjo vlerë. Pastaj, zotohet se prodhimet janë më të mira në rajon dhe kjo thuhet në materialin që na është dorëzue, por ne nuk kemi ndonjë kopje të çertifikatës të këtyre produkteve. Mendoj se çdo produkt duhet të jetë i çertifikuar kur të jetë i cilësisë së mirë. Aty, thuhet se 80 ari nga sipërfaqja e shfrytëzuar janë shpronësuar nga Ministria përkatëse, por nuk e dijmë se kompania a është dëmtuar, apo i është kompensuar kjo sipërfaqe dhe nëse po, sa është shuma e kompensimit të kësaj sipërfaqeje të shpronësimit për autostradë. Nuk e dijmë se nëse, harxhohen rezervat e argjilës ose z.Maloku, për ndonjë arsye e ndërprejnë këtë aktivitet çfarë pune do të përdoret në këtë sipërfaqe të tokës sepse në Komunën tonë kur është bërë privatizimi i pronës nga AKP-ja, në përgjithësi këtyre pronave ju është ndërruar destinimi. Unë në rastin konkret e kam fjalën për tokat bujqësore në Milloshevë dhe Llazarevë, sipërfaqja prej dhjetëra hektarëve tokë nën sistemin e ujitjes dhe tani sa vite krejtë kjo sipërfaqe është duke u ndërtuar dhe duke u kthyer në tokën ndërtimore. Unë përkundër që kam kërkuar të ndërprehet urgjentë ndërtimi, kërkesa ime nuk merret parasysh nga ju dhe arsyeja e vetme sipas drejtorit Arben Berisha, dhe Kryetarit është se derisa nuk kemi plan rregullativ nuk mund të ndërprehet, por do të vazhdohet me kthimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Të gjitha pikat e përmendura më lartë dhe historia e mëhershme e dhënies së pronave në kohëzgjatje prej 99 viteve, më bën të besoj se Kryetari bashkë me Drejtorinë përkatëse, nuk e merrë parasysh interesin e qytetarëve, por vetëm interesin e ngushtë dhe si rrjedhojë unë do të abstenoj.

Lulzim Sadiku – Unë në fakt e kam marrë ftesën prej Kryetarit, por kam qenë në pushime dhe nuk kam mund me dhënë kontributin tim. Parafolësi ka të drejtë në shumë pika që deshta ti them edhe unë dhe Kolegji Biznesi, nuk e di a është akreditue nga se është mirë të mos ngutemi sepse shumë universitete shtetërore nuk janë akreditue dhe ti japim ne mundësi për 99 vite. Unë sa e di ky e ka marrë parcelën për 10 ose 15 vjet. Sa i përket Apollonisë SH.P.K. në fakt ky është tregue një biznesmen shumë i mirë ka kontribue, ka premtue se në 3 vjeçarin e ardhshëm do ti mbjellë 20,000 ose 200,000 drunj dekorativ dhe unë dua të di rreth kësaj se a ka dru dekorativ. Për punëtorët që ka premtue se do ti punëson, është dashur me na dhënë një listë të punëtorëve, që me ditë se a janë punëtorë të Komunës tonë apo jo. Kërkoj që ky investitor të na sjellë një listë të punëtorëve, që ne të shohim se a janë punëtorë të Komunës tonë sepse pagesa që ia bën Komunës 60,000 €, mendoj se është shumë e vogël nga se Komuna jonë ka arritë me

pasë buxhet ndër Komunat më të mira dmth ne e kemi Ligjin për Obiliqin dhe kemi mjaft buxhet dhe pasi kanë mundësi e hapësirë me punue, atëherë nuk kisha me u ngutë. Nëse, kolegji Biznesi nuk ka akreditim pse ne me ia dhënë tokën për 99 vite, kur ai nuk akreditohet me mbajtë ligjërata hiç. Ju, e dini se ky problem është shumë madhor për Kosovën, prandaj kisha dashur që kjo të shtyhet për Apolloninë, ndërsa për Kolegjin Biznesi, jam kundër që ti jepet mundësia për 99 vite.

Kryetari – Seriozisht ne jemi munduar me qenë sa më transparentë dhe është e vërtetë se edhe z.Aziz, ka qenë atë ditë prezentë, ishte me i përcjellë edhe prezentimet e kompanive. Qëllimi është për zhvillim ekonomik dhe fillimisht fokusohem te Apollonia, sa kam qenë Kryetar në mandatin e kaluar asnjëherë nuk ka ndodhë me kalue një periudhë e caktuar kur ai ka marrë punëtorë, që nuk ju ka drejtue edhe Entit për punësim, por edhe Komunës. Numrin e ka përmendë nëse, nuk gaboj 40, ose 60 që do të jetë plotësues me kapacitetet që ai do ti rritë. Sa i përket çështjes së revitalizimit të tokës, ne e dijmë të gjithë se këtë çështje e trajton Agjensioni i minjerave dhe mineraleve dhe asnjë prodhues që ka të bëjë me eksploatim të tokave duke filluar prej gurëthyesve, KEK-ut, prodhuesve të bllokave kanë një deponim, garancion sipas ligjit, që nëse ata nuk e bëjnë sanksionohen. Pastaj, Agjensioni i minjerave dhe mineraleve planifikon bazë të eksploatimit dhe pagesës së tantimës, ata duhet me rikthye në gjendjen e mëhershme. Kapacitetin e prodhimeve, ai e ka potencue edhe atë ditë sa që është shumë e kërkuar në treg dhe nuk është duke e mbushë tregun, qysh e përmendi ai ka kërkesa edhe për export jashtë vendit. Ka edhe kërkesa tjera, që janë adresue në Komunë, por ka edhe për të njejtën parcelë dhe i kemi ftue edhe ata nëpër takime. Në kontratë do të specifikohen të gjitha çështjet dhe nëse, në afatet kohore bizneset nuk i realizojnë në bazë të planit dinamik që e kanë prezentue, Komuna e gëzon të drejtën me ia marrë pronën. Nëse, ai në të ardhmen nuk çertifikohet ne në kontratë mund ta lejmë një aneks që nuk ka të drejtë me tjetërsue pronën, por Komuna mund ta kthej prapë në shqyrtim se cili do të jetë vendimi për këtë çështje.

Hysni Mjeku – Unë në debatin publik nuk kam marrë pjesë sepse isha pjesë e Komisionit për ndryshimin e Statutit të Komunës, por kjo materie është trajtuar në KPF. Besoj se është interesi i Komunës, që ato pjesë që kanë qenë djerrina të shfrytëzohen maksimalisht. Sa i përket prodhimit është interes i punëmarrësit sepse ai me mund edhe me miliona blloka i shet, por mbi të gjitha është interesi i përgjithshëm dhe në KPF, i kemi dhënë përkrahje dhe jemi pro këtij projekti.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” miratuan Vendimin për dhënien e pronës të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për ofertuesit Kolegji Biznesi.

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Llazarevë për Investitorin Apollonia SH.P.K.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 2 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” miratuan Vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit Apollonia SH.P.K.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për ridestininim të mjeteve dhe për sqarim detal fjalën ia jepë drejtoreshës.

Zarife Behluli –Ju, e dini se rishikim prej Ministrisë së financave nuk ka pasë dhe ne si Komunë jemi të obliguar që për mjetet që lidhet kontrata dhe mbeten mjete të lira mund ti ridestinojmë në projekte tjera me vendim të Kuvendit. Nga kogjenerimi kanë mbetë mjete të lira 111,400 €, furnizim me kontejnerë 775 €, pajisje mjekësore 19,357 €, dhe shtatorja “Xhavit Haziri” 44,667 €, që në total mjete të lira janë 176,199 €. Në total asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuare janë 151,680.69 dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara 24,518.31, që në total bartje të mjeteve janë 176,199 €.

Lulzim Sadiku – Unë konkretisht po i shohë shumat e mëdha që kanë teprue dhe ku janë dedikue, por gjithmonë po biejmë në lajthitje drejtoreshë, asfaltimi i rrugëve rurale, trotuareve 86,81.69 €, dhe prapë këtu, kemi asfaltim të rrugëve, pajisjet mjekësore kalojnë në asfaltim të rrugëve dhe trotuareve. Pyes pse

drejtoreshë nuk po i specifikon cilat rrugë, cilat trotuare, por gjithmonë boshe dhe ne nuk e dijmë vetëm se krejtë kalojnë në asfaltim të rrugëve dhe trotuareve. Mendoj se duhet të ceket se në cilat rrugë po kalojnë psh shuma prej 24,518.31, në 86,881, të ceket cila rrugë, ose cili trotuar, në mënyrë që ne të dijmë se ku po i dërgojmë këto mjete. Mirëpo, gjithmonë është e njëjtë ku kanë teprue po duken shumat e mëdha dhe gjithmonë kanë shkue në asfaltim të rrugëve dhe trotuareve. Duhet të mësohemi se në cilën rrugë dhe në cilin trotuar po i dërgojmë mjetet për të cilat po e ngritim dorën.

Kryesuesi – Përgjegjet se kodi i investimeve kapitale është asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve. Besoj se këtë vit jemi duke ia pa të mirat vendimit të vitit të kaluar të dt.26 shtatorit 2018, që ne i kemi përcaktue investimet kapitale nëpër çdo lokalitet dhe e kemi sjellë listën e investimeve kapitale. Tash, jemi në fazën e punëve dhe në çdo fshat jemi duke kryer rrugë, investime kapitale dhe ajo vijë po mbushet. Mbetja e tyre nuk është mbetje e madhe sepse inxhinjerët e kanë paraparë, por oferta më e lirë ekonomike e ka bërë të veten që operatorët ekonomik me ardhë me çmime më të lira. Ky është kodi i investimeve që ne e kemi votue dhe mjetet 176,199 €, kalojnë në atë kod dhe mbulohet pjesa e rrugicave e trotuareve, sipas nevojës dhe planit vjetor që e ka zyra e Kryetarit.

Zarife Behluli – Është më mirë që ne këto mjete po i dërgojmë në asfaltimin e rrugëve për arsye se janë shumë kontrata të lidhura te ai asfaltim dhe me pasë edhe më shumë mjete ne kishim me i dërgue te asfaltimi i rrugëve. Nëse, ne nuk i dërgojmë këto mjete te asfaltimi atëherë, këto mjete i merrë Qeveria.

Lulzim Sadiku – Unë nuk pajtohem që po shkojnë krejtë në atë mënyrë sepse ne kemi sjellë lista, kemi kalue buxhet dhe kemi përfshi rrugë psh rruga “Bregu” anashkalohet tërësisht prej vitit 2014, që ka kalue përmes buxhetit. Për atë ky asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve po bëhet pak në mënyrë politike për me fitue vota, prandaj do të abstenoj edhe pse është në interes të Komunës së Obiliqit, që mjetet të mos shkojnë në thesar, pasi që po bëhen këto ndarje unë dhe grupi do të jemi kundër.

Kryesuesi – Sqaron se ne nuk kemi mund me shtrure rrugën pa e krye kanalizimin, por tash është krye kanalizimi dhe rruga do të shtrohet.

Lulzim Sadiku – Kanalizimi është bërë për pjesën e djathtë të lagjes, që nuk ka të bëjë kurgjë me rrugën. Ju mund ta shikoni se në buxhet të vitit 2014, rruga “Bregu” ka kalue dhe nuk është ndërtue asnjëherë. Kërkoj të mos politizohen rrugët, por të shkohet sipas propozimeve që janë dhënë psh në vitin 2014.

Kryesuesi - Mund të them se investimet komunale nuk shtrihen politikisht, por shtrihen në interesin publik të qytetarëve dhe besoj se asaj rruge tash i vjen prioriteti dhe është në proces.

Lulzim Sadiku - Unë tregova se në cilin vit ka kalue dhe deri tash nuk u shtrure, për këtë arsye po flas me fakte se në buxhetin e vitit 2014, ka kalue, por nuk ka përfundue asnjëherë.

Kryesuesi - Unë për vitin 2014, nuk e di, por e di se në vitin 2018 ne jemi bashkë këtu, dhe e di se drejtoresha e financave me 1 shtator na e sjellë një Draft buxhet për vitin 2020. Debatet publike janë caktue dhe ju lus, që të merrni pjesë të diskutojmë bashkarisht për buxhetin e vitit 2020.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” dhe 6 vota “Kundër” e miratuan Vendimin për transferin dhe ri-alokimin e mjeteve për vitin 2019.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shkresën nga MAPL-ja, për shfuqizimin e vendimit lidhur me aprovimin e Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët, për çmimin e energjisë elektrike në zonat e rrezikuara mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Lulzim Sadiku – Unë kam qenë kundër kur është aprovue kjo Rregullore sepse subvencionet në Komunën e Obiliqit, po keqpërdoren, po kushtëzohen dhe nuk është caktue se kush do të përfiton nga kjo Rregullore. Poashtu, janë shkue shkelë e shko dhe konkretisht ka përfundue si e parregulltë. Kërkoj që për subvencionet në këtë mënyrë të cekën në mbledhjen e ardhshme se qysh do të vepruhet me ato, e jo qysh kemi mendue me veprue dhe e kemi marrë që është e paarsyeshme.

Kryesuesi – Subvencionet nuk i keqpërdorim, por ato janë për ekonomitë familjare dhe numri i njehsorëve elektrik është marrë me ju ndihmue familjeve. Nëse, ju keni fakte është Prokuroria që mund ti drejtoheni dhe sigurisht se edhe ne si Kuvend komunal, do të përkrahim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota "Për" dhe 2 vota "Abstenim" e miratuan shfuqizimin e Vendimit nr.I-116, të dt.28.06.2019, për Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DKA, për rrënimin e objektit shkollor në Raskovë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota "Për" e miratuan Vendimin për rrënimin e objektit shkollor SHFMU "Hasan Prishtina" në Raskovë, në mënyrë që të lëshohet hapësira për shkollën e re.

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me këto kërkesa:

Kërkesa nga Agon Hashani, për emërimin e rrugës në lagjen e Hashanëve me emrin "Mulla Xhemajli", i drejtohet DPUKP-së për shqyrtim.

Kërkesa nga Behxhet Gërvalla, për emërim të rrugës me emrin "Sejdi Gërvalla" në Raskovë. i drejtohet DPUKP-së për shqyrtim.

Kërkesa nga Besmir Pula, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, i dërgohet Drejtorisë së inspeksionit dhe DPUKP-së, për shqyrtim.

Kërkesa nga KBI, Obiliq për një autoambulancë për lehtësim të punëve në terren i dërgohet Këshillit të drejtorëve dhe DSHMS-së, për shqyrtim.

Kërkesa nga Besa Selmani, për ndihmë me mjete financiare për pajisje adekuate sportive, i drejtohet DKRS-së, për shqyrtim.

Pika 11 e rendit të ditës

Xhezide Dragusha – Deshta ta falenderoj drejtorin e DKA-së, z.Agim Spahiu, për urimet e djalit për fitoren. Unë e kam një kërkesë prej prindërve të shkollës "Hasan Prishtina" në Milloshevë për mirëmbajtjen e perdeve dhe ata kanë kërkuar meqë përmes prindërve është investuar aty, të mirëmbahen ato perde, tash për shkak të pengesës së diellit, nxehtësisë që depërton nëpër klasa.

Aziz Bici – Fjala është për ndërtimin e sheshit, punët janë ndërprerë, që e keni parë edhe ju ndoshta keni keni ndonjë informacion zyrtar sepse ka 2,3 javë që s'po punohet hiç. Pluhuri dhe balta aty është pengesë shumë e madhe. Pyes, çka është duke ndodhë këtu, a ka heqë dorë kompania apo çka është në pyetje.

Arben Berisha – Përgjegjet se kemi telashe me shpronësim të banesave dhe lokaleve, jemi në procedurë dhe kjo po merrë kohë. Sa i përket lokaleve nëse, Qeveria e merrë mandatin në e bëjmë shpronësimin, e nëse jo deri në formimin e Qeverisë së re nuk ka shpronësim.

Labinot Mirena – Pyeti se a ka afat ligjor.

Arben Berisha - Përgjegjet se ka afat ligjor, por kemi probleme se po shtyhen punimet për arsye se DPUKP, nuk po mund të vazhdoj me procedura të shpronësimit. Sa i përket banesave, jemi në rregullë dhe procedura po ecë dhe ata kanë ankesa, por ankesat nuk mund ti ndalin punimet.

Aziz Bici – Ju e keni parë se dikund rreth 9,000 m², ka pozicione të mjaftueshme që me punue aty. Unë nuk po them që mos të pritët shpronësimi, por ka hapësirë të mjaftueshme, që së paku të evitohet ajo gjendje e rëndë.

Shaip Paloja – Edhe dje janë mbajtur disa takime prej një kompanie të angazhuar nga KEK-u, për 4 fshatra Palaj, Hade, Sibofc dhe Shipitullë, për zhvendosjen e pjesërishme të këtyre fshatrave. Unë dje kam qenë në 2 takime dhe më çuditi fakti se vetëm 1 person i Komunës ishte z.Shaip Mehmeti. Mendoj se Komuna, duhet shumë më shumë me qenë prezentë në ato takime dhe me marrë informata të sakta që në të ardhmen me ditë me ju drejtue komunitetit se çka po ndodhë.

Lulzim Sadiku – Kërkoj që të rregullohet çështja e zyrës këtu, ku jemi, konkretisht kemi biseduar shumë herë që të ketë klimë zyra ku po mbajmë takim dhe të ketë varëse. Poashtu, kërkoj që të rritet edhe sekretaria e Kuvendit sepse po kemi shumë obligime. Unë kam kërkuar edhe shumë herë kur po bëhet votimi të ceket me emër kush si po voton. Unë e kuptoj se numri është shumë i vogël i punëtorëve dhe

është vështirë të kryhen punët ne sekretari të Kuvendit, prandaj kërkoj nga kryesuesi të gjendet mundësia dhe të ecim përpara.

Kryesuesi – Sekretarinë e Kuvendit e kemi paraparë edhe me Statut të Komunës dhe ju e dini se Statuti i Komunës është në debat publik, do të thotë ndryshimi dhe plotësimi i Statutit. Ndërsa, çështja e zyrës është çështje teknike, është problem i investitorit që e ka lënë deri në këtë fazë. Drejtorja e administratës është duke u marrë me këtë çështje që me rregullue ne me buxhet edhe njëherë çështjen e inventarizimit.

Nazmi Gashi – Pyeti se çka u bë me kartela të anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi – Përgjegjet se ata që janë dalë në fotografi 7,8 vetë i kemi dërguar dhe po presim.

Hysni Mjeku – Pyeti lidhur me parkingun në Graboc të Epërm, janë kryer punimet te xhamia e fshatit kur do të bëhet kufizimi i parkingjeve aty.

Kryesuesi – Përgjegjet nuk e di.

Fatmir Bërbatovci – Drejtorja jonë e ka realizue një projekt shumë të rëndësishëm për qytetin tonë, bëhet fjalë për unazën e qytetit. Lënda është procedue, kontrata është lidhë dhe punën kemi filluar, por inspektorët e hekurudhës kanë ardhë dhe e kanë ndalue punën. Arsyeja është se prona nuk është bartë nga hekurudha në Komunën tonë, përkatësisht në DPUKP. Edhe pse ne e kemi një vendim përfundimtar të vitit 2012, e kemi elaboratin ku na është thënë që kjo pronë prej hekurudhës ka kalue në Komunë, gjë që nuk ka ndodhë. Meqë, hekurudha ka bërë ankesë dhe Gjykata ka aplikue një masë të përkohshme procedura është bllokue. Ne këtë gjë nuk e kemi ditë sepse në aparat kadastral nuk është regjistruue masa e përkohshme. Ju duhet ta merrni një vendim për shpallje të asaj zone me interes publik dhe kjo DPUKP-së, ia mundëson me i ndjekë procedurat për shpronësim.

Aziz Bici – Kërkoj të na ofrohet një dokument në mënyrë që të dijmë se çka po votojmë. Unë nuk do të votoj kështu, veç pse po kërkohet dhe veç që e shpjegoj edhe përkundër faktit se ai projekt duhet të përkrahet me çdo kusht. Mirëpo, për shkak të rregullës dhe përgjegjësisë së votës ne duhet ta kemi një dokument që ta lexojmë, pastaj të votojmë.

Lulzim Sadiku – Edhe unë pajtohem me parafolësin se është mirë të kemi një dokument dhe e kuptojmë se ndoshta është me prioritet, por nëse kemi pritë 19 vjet pasluftë po presim edhe një muaj që të vjen me dokument, që të jemi të informuar mirë dhe konkretisht ta votojmë. Edhe unë do të jem kundër edhe pse kam respekt shumë për drejtorin, por është çështje që duhet ta dijmë pak më thukët.

Enver Gashi – Mendoj se ne jemi të njohur të gjithë që vendosim për këtë problematikë dhe nëse, ne kërkojmë administratë veç kemi me ia shtye vetes sepse nuk është diçka që nuk e kemi të qartë. Unë jam për atë që të votohet sot, të ecin procedurat për të mos e zënë dimri atë pjesë sepse edhe ashtu e kemi pjesën tjetër te sheshi pothuajse, të bllokuar dhe të mos e bllokojmë qytetin.

Shaip Paloja – Pyeti se cila pronë po kërkohet të shpallet zonë me interes sepse nuk munda me kuptue nëse, është pronë e hekurudhës a kemi të drejtë me shpallë zonë me interes.

Fatmir Bërbatovci – Përgjegjet se kemi të drejtë, prandaj edhe e paraqitëm kërkesën.

Nazmi Gashi – Ne nuk po japim asgjë dhe nëse, na jepet diçka në shërbim tonin, atëherë ne nuk kemi nevojë me nxjerrë telashe, prandaj ta votojmë dhe të rregullohet çështja në mënyrë administrative juridike.

Aziz Bici – Mos të mësohemi me na i ktheje vendimet sepse shpesh po na i kthejnë vendimet, pse po nguteni kështu, besoni po ngushtohem kur po na i kthejnë vendimet prapa dhe ngushtoheni edhe ju njëherë. Tash, është mundësia me postë elektronike me na i dërgue materialet dhe pse nuk na dërguat së paku 1 ditë përpara. Neve, duhet me na ardhë keq kur po na i kthejnë vendimet dhe nuk është çështja vetëm të votojmë, por të mësohemi ti lexojmë, analizojmë, të konsultohemi me zyren për çështje ligjore, me ekspertë të fushave, pastaj të votojmë dhe vendimet të mos na kthehen prapa.

Kryesuesi – Kjo është kërkesë urgjente që drejtori e prezantoi dhe shpjegoi çështjen. E përmendi edhe z.Nazmi Gashi, se ne nuk po japim asgjë, por po e zgjidhim një problem të kahmotshtëm, ta votojmë ndërsa me çështje tjera merret Ekzekutivi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” e miratuan Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.

Mbledhja përfundoi në ora 12:43’

Bashk.prof për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri